



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401214/17

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet ndërhyrja e organit që ju përfaqësoni mbi veprimtarinë e ZQRPP, Tiranë, si dhe ZVRPP, Fier, për zgjidhjen e çështjes së shtetasit T.M.*

Drejtuar : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

I nderuar Z.Manjani!

Në cilësinë e përfaqësuesit të organit që administron veprimtarinë e regjistrimit publik për pasuritë e paluajtshme, sikurse parashikuar në nenin 198 të Kodit Civil, në të cilin thuhet se;

"Ministria e Drejtësisë administron veprimtarinë e regjistrimit publik për pasuritë e paluajtshme", prezantoj para jush çështjen si më poshtë përshkruar;

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim çështjen e prezantuar prej shtetasit T.M., me banim në Lagjen "16 Prilli" Rruga "Llukan Toska", Fier, në të cilën shprehet shqetësimi i shkeljes të së drejtës reale mbi pasuri të paluajtshme prej ZVRPP, Fier. Institucioni që unë përfaqësoj, ka konsideruar, se, pretendimet e ngritura prej ankuesit janë të drejta.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka rekomanduar me Shkresësn nr. K3/T12-5 Prot, datë 17.06.2015, Regjistruetit të ZVRPP, Fier :

"Marrjen e masave për lëshimin e dokumentave të pronësisë shtetasit T.M. etj, për pasurinë e regjistruar me nr.143, datë 21.02.2005 të rregjistrimit hipotekor apo sot me nr. 7/9, Vol 11, Faqe 15, të regjistrimit të ZVRPP, Fier".

Në përgjigje të rekomandimit të dhënë, Regjistrueti i ZVRPP, Fier, me shkresën nr.4918/1 Prot, datë 10.07.2015, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, justifikon

në mënyrë të parregullt dhe pa shkak të ligjshëm, mosmarrjen në konsiderat të rekomandimit të dhënë, duke vijuar në këtë mënyrë shkeljen e të drejtës së pronësisë, të të drejtave reale të ankuesit, mbi pasuri të paluajtshme, sikurse përcaktuar në Vendimin nr.152, datë 03.12.1994, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ish-Pronarëve, Fier, ndryshuar me Vendimin Gjyqësor nr.460, datë 08.04.2002, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier.

Ndodhur në këto kushte, referuar parashikimeve të nenit 23 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, është rekomanduar me shkresën nr. K3/T12-8 Prot, datë 05.08.2015, Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë,

“Ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Fier, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunktionimit, në çështjen e shtetasit T.M, për të cilën, Institucioni i Avokatit të Popullit me shkresën nr. K3/T12-5 Prot, datë 17.06.2015, ka rekomanduar kryerjen e veprimeve të cilat mundësojnë rivendosjen në vend të së drejtës reale të shkelur ankuesit mbi pasuri të paluajtshme”.

Edhe pse është kërkuar me shkresën nr.K3/T12-12 Prot, datë 05.01.2016 apo Proces-verbalin datë 16.05.2016, të mbajtur me Përgjegjësen e Sektorit Juridik pranë ZQRPP, Tiranë, mundësimi i kthimit të përgjigjes për rekomandimin e dhënë, në afatin e parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, konstatohet se, përmbushja e detyrimit ligjor brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të shkresës nr. K3/T12-8 Prot, datë 05.08.2015, prej Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë, nuk ka ndodhur.

Përkundër kësaj situate, si më sipër prezantuar, gjykojmë se, qëndrimi i Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efiçencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të detyrueshme për zbatim në kuptim të parashikimeve të kryera në nenin 1 të këtij Kodi.

Situatën në të cilën ndodhet çështja e prezantuar e vlerësojmë jo në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 *“Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.*

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se; *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”*, si dhe nenit 22 dhe 23 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar,

REKOMANDOJMË

Ndërhyrjen e organit që ju përfaqësoni mbi veprimtarinë e ZQRPP, Tiranë, si dhe ZVRPP, Fier, për zgjidhjen e çështjes së shtetasit T.M.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit, konform parashikimit të kryer në nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë,

Kopje të shkresës nr. K3/T12-8 Prot, datë 05.08.2015, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryeregjistuesit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të fragmetit të Gazetës Shqiptare, datë 14.12.2014.

Kopje të shkresës nr. K3/T12-12 Prot, datë 05.01.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryeregjistuesit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të Proces-verbalit datë 16.05.2016, të mbajtur me Përgjegjshen e Sektorit Juridik pranë ZQRPP, Tiranë.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktiligrafoi

A.Gjoleka